

Në bazë të nenit 12 dhe 49 të Ligjit për Organizatat Joqeveritare („Gazeta Zyrtare e Malit të Zi”, nr. 39/11) dhe nenit 45 të Statutit, Kuvendi i Fondacionit joqeveritar „Aleanca Qytetare”, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2012, miratoi *NDRYSHIMET* dhe *PLOTËSIMET* e

STATUTIT TË FONDACIONIT „Aleanca Qytetare”

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Aleanca Qytetare (në tekstin e mëtejshëm: AQ) është fondacion joqeveritar jofitimprurës, i krijuar me Vendimin mbi themelimin e AQ-së, më 01. 06. 2011.

Themeluesit e Fondacionit janë:

OJQ “Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut”, me seli në Podgoricë, e regjistruar në Regjistrin e organizatave joqeveritare më 23. 08. 2006, nën numrin rendor 3640;

dhe

OJQ “35 mm”, me seli në Podgoricë, e regjistruar në Regjistrin e organizatave joqeveritare më 28. 02. 2007, nën numrin rendor 3867.

Neni 2

Me Statutin e AQ-së rregullohen qëllimet themelore të veprimit, zgjedhja e organeve dhe trupave, parimet e punës, organizimi i brendshëm, të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve/eve, kompetencat e organeve dhe trupave, si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e AQ-së.

Neni 3

Emri i plotë i OJQ-së është “Aleanca Qytetare”.

Emri i shkurtër i Shoqatës është “AQ”.

Neni 4

Selia e AQ-së është në Podgoricë, Rr. Vukice Mitrović, nr. 16.

AQ mund ta realizojë veprimtarinë e vet dhe në shtete të tjera.

Neni 5

Vula e AQ-së është në formë të rumbullakët, në skajet e së cilës me shkrimin latin është shkruar emri i plotë Nevladina fondacija “Građanska alijansa”, kurse në mes „Podgorica“.

Neni 6

AQ ka shenjën e vet.

Shenja e AQ-së janë një mori siluetash të njerëzve me ngjyra të ndryshme. Emri i plotë i AQ-së është shkruar me shkrimin latin në gjuhën malazeze, angleze dhe shqipe.

Vendimin mbi ndryshimin e simbolit të AQ-së e merr Këshilli Drejtues me propozim të Kryetarit të Fondacionit.

Neni 7

Qëllimet dhe detyrat e AQ-së janë:

- Ndërtimi i Malit të Zi si një shoqëri demokratike, qytetare dhe e përgjegjshme në të cilën respektohen të drejtat e njeriut
- Kontributi për respektimin e sundimit të ligjit
- Zhvillimi i gazetarisë hulumtuese
- Krijimi i politikave publike në fushat e ekspertizës së saj.

Neni 8

Në përputhje me qëllimet e parashtruara, AQ do të veprojë për realizimin e detyrave të mëposhtme:

1. të sigurojë mbështetje, përfshirë edhe ndihmën financiare, për nismat e qytetarëve që kanë për qëllim arritjen e objektivave të AQ-së;
2. të mundësojë edukimin mbi shoqërinë qytetare dhe të drejtat e njeriut;
3. të mbledhë dhe shpërndajë informacione mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit;
4. të inkurajojë zhvillimin e gazetarisë hulumtuese;
5. në përputhje me ligjin, të botojë libra dhe publikime të tjera që i dedikohen zhvillimit të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shoqërisë qytetare;
6. të promovojë vlerat e AQ-së, të përcaktuara në qëllimet e saj;
7. në përputhje me ligjin, të organizojë – vetë ose së bashku me organizatat e tjera – konferenca shkencore, takime konsultative, seminare dhe forma të tjera të arsimit profesional në këtë fushë.

Neni 9

AQ është fondacion joqeveritar, jofitimprurës dhe jopartiak.

AQ ka cilësinë e personit juridik.

AQ kryen veprimtari vetëm për qëllime bamirësie, shkencore dhe arsimore, të cilat janë me interes dhe rëndësi publike, në përputhje me Ligjin dhe këtë Statut.

Neni 10

Puna e AQ-së është publike dhe transparente.

Transparenca e punës së AQ-së sigurohet nëpërmjet komunikatave për shtyp, publikimit të Raportit financiar vjetor dhe të dhënave të tjera me rëndësi për punën e Fondacionit në faqen e internetit të Fondacionit, konferencave për shtyp, publikimeve periodike dhe të veçanta, si dhe mënyrave të tjera të përshtatshme.

Neni 11

AQ i kryen aktivitetet e veta vetëm për qëllime bamirësie, shkencore dhe arsimore, në përputhje me ligjin.

Asnjë mall apo pronë e AQ-së nuk guxon të përdoret për qëllime private apo për qëllime të organizatës fitimprurëse, me përjashtim të rasteve të përcaktuara me nenin 11 të këtij Statuti.

Ky kufizim nuk zbatohet për pagesën e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve të AQ-së.

Personat fizikë ose grupet e personave fizikë nuk mund të kenë pjesë të pronësisë në AQ, as në të mirat që ajo prodhon.

Neni 12

AQ nuk mund të marrë pjesë në fushatat e partive politike ose të kandidatëve/eve për poste publike, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthorazi.

AQ nuk mund të angazhohet në ndryshimin ose miratimin e ligjeve të reja, as nuk mund të llojë për ndryshimet e legjislacionit.

Neni 13

AQ i realizon qëllimet e saj përmes organizimit të veprimtarive publike të ndryshme, seminareve dhe konferencave, programeve mediatike dhe veprimtarisë botuese, në përputhje me ligjin.

AQ në kuadër të aktiviteteve të saj bashkëpunon me mediat, shoqatat e qytetarëve dhe organizatat e institucionet e ngjashme në vend, rajon dhe botë.

AQ mund të bashkëpunojë vetëm me organizatat që ndajnë vlera të përbashkëta me të dhe që punojnë në mënyrë transparente.

AQ në kuadër të veprimtarisë së saj mund të themelojë subjekte të tjera juridike, të cilat do të merreshin me aktivitete specifike, siç janë produksioni i programeve radiofonike dhe programeve televizive, shtypja dhe shpërndarja e materialeve, ofrimi i shërbimeve nga fusha e hotelierisë dhe turizmit etj.

Këto subjekte juridike mund të sigurojnë fitim i cili përdoret vetëm për arritjen e qëllimeve të AQ-së.

Përfaqësuesit/et në organet drejtuese të organizatave të themeluara nga AQ-ja i zgjedh Bordi i Drejtorëve të AQ-së.

Neni 14

Për fillimin e punës, AQ siguron mjete financiare në shumë prej 10 (dhjetë) Euro nga themeluesit e tij.

Mjetet financiare nga paragrafi i mëparshëm, të siguruara për fillimin e punës, AQ i përfiton pa obligim që t'i kthejë.

Neni 15

Mjetet financiare të AQ-së shpërndahen dhe ruhen në kushtet më të favorshme.

Mjetet financiare të AQ-së depozitohen në llogarinë bankare të AQ-së.

Neni 16

AQ fiton dhe siguron mjete financiare në përputhje me Ligjin dhe këtë Statut.

AQ do t'i grumbullojë mjetet financiare të nevojshme për veprimtarinë e saj nëpërmjet dhuratave dhe donacioneve, aplikimit me projektet e veta tek organet shtetërore, organizatat vendore dhe të huaja, fondacioneve dhe personave fizikë.

Me qëllim të arritjes së qëllimeve të saj, AQ mund të pranojë trashëgimlënie, dhurata dhe të drejtat e autorit nga personat bamirës, themeluesit dhe donatorët e tjerë.

AQ mund të sigurojë dhe të grumbullojë të ardhura nga qiradhënia, interesi nga mjetet e depozituara, dividenda, të ardhurat nga të drejtat e autorit dhe licencat, në përputhje me Ligjin dhe me këtë Statut.

Neni 17

Si fondacion joqeveritar jofitimprurës, AQ do të funksionojë në baza krejtësisht jofitimprurëse, dhe në këtë aspekt të gjitha mjetet e fituara për punën e vet do t'i investojë në zhvillimin programor dhe arritjen e qëllimeve për të cilat është themeluar, në mënyrën e përcaktuar nga themeluesit.

AQ shfrytëzon dhe disponon me pasurinë në mënyrë ekonomike dhe racionale, me qëllim të ruajtjes dhe shtimit të saj.

Organet dhe Trupat e AQ-së

Neni 18

AQ-në e përfaqëson dhe e prezanton Kryetari i Fondacionit.

Neni 19

Organet e AQ-së janë.

- Personi i autorizuar për përfaqësim – Kryetari
- Këshilli Drejtues
- Këshilli Mbikëqyrës, si organ kolektiv

Neni 20

Mandati i Kryetarit të AQ-së zgjat dy vjet.

Mandati i organeve të tjera të AQ-së zgjat dy vjet. Ai mund të përfundojë para kohës së përcaktuar në rastet e mëposhtme:

- dhënies së dorëheqjes me arsyetim të anëtarit të Këshillit Drejtues
- shkarkimit me vendim të themeluesit për shkak të mospërmbushjes së qëllimeve të Fondacionit ose për shkak të veprimit në kundërshtim me aktet e Fondacionit.

Pas përfundimit të mandatit, ata mund të zgjidhen edhe një herë në të njëjtin funksion.

Neni 21

Për miratimin e vendimeve të vlefshme në të gjitha organet dhe trupat e AQ-së nevojitet që të jenë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve/eve të atij organi apo trupi, përveç nëse me këtë Statut është përcaktuar ndryshe.

Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç nëse me këtë Statut është përcaktuar ndryshe.

Zgjedhjet për organet dhe trupat kryhen zakonisht me votim të hapur, përveç nëse organi që zgjedh vendos ndryshe.

Neni 22

Këshilli Drejtues është organi më i lartë qeverisës i AQ-së.

Këshilli Drejtues ka katër anëtarë dhe përbëhet nga:

- Kryetari
- Drejtori i programit
- Drejtori ekzekutiv
- Drejtori i komunikimit

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga themeluesit e Fondacionit.

Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të jenë anëtarë të organeve të tjera të Fondacionit.

Këshilli Drejtues ka kryetarin i cili udhëheq punën e Këshillit.

Kryetarin e Këshillit Drejtues e emëron themeluesi/t i/e Fondacionit.

Aktet e Këshillit Drejtues i firmos kryetari i Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues mbledhet të paktën një herë në muaj.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues i thërret dhe i kryeson Kryetari.

Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë edhe personat e tjerë, të cilët i ftojnë anëtarët në mbledhje, prania e të cilëve është me rëndësi për punën e Këshillit.

Neni 23

Kompetencat e Këshillit Drejtues:

- emëron dhe shkarkon Personin e autorizuar për përfaqësim
- miraton Statutin
- miraton Raportin financiar vjetor
- vendos për disponimin e pasurisë
- nxjerr Rregulloren e tij të punës
- nxjerr Vendimin mbi ndryshimin e qëllimeve dhe veprimtarisë
- vendos edhe për çështje të tjera për të cilat me Statut nuk është përcaktuar kompetenca e organeve të tjera të Fondacionit
- kryen punë të tjera në përputhje me ligjin, aktin e themelimit dhe Statutin
- me propozim të Kryetarit të Këshillit Drejtues nxjerr vendimet mbi themelimin dhe shpërbërjen e trupave të AQ-së
- nxjerr Vendimin mbi bashkëpunimin strategjik me organizata të tjera vendore dhe ndërkombëtare
- nxjerr Vendimin për themelimin e personave të tjerë juridikë, themelues i të cilëve është AQ-ja
- miraton dhe mbikëqyr realizimin e Planit vjetor të punës

- zhvillon programe të reja në përputhje me misionin e AQ-së
- prezanton AQ-në në opinion
- miraton Rregulloren e tij të punës me propozim të Kryetarit/es të/së Këshillit Drejtues
- me propozim të Drejtorit të programit mund të ndajë mirënjohje të posaçme për personat që kanë dhënë kontribut të madh në punën dhe zhvillimin e AQ-së

THIRRJA E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 24

Këshilli Drejtues mbledhet me iniciativë të themeluesve, pastaj me iniciativën e të paktën një anëtari të Këshillit Drejtues, Kryetarit të Këshillit Drejtues si dhe Personit të autorizuar për përfaqësim, përmes ftesës me shkrim mbi vendin dhe kohën e mbajtjes, si dhe propozimin e rendit të ditës, të dërguar së paku shtatë ditë përpara mbajtjes së mbledhjes.

Krahas ftesës për mbledhjen e Këshillit Drejtues, anëtarit i dërgohet edhe materiali përkatës (raportet, analizat, bilancet, propozim vendimet etj.).

MËNYRA E VENDIMMARRJES

Neni 25

Këshilli Drejtues vendos nëse në mbledhje janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

PROCESVERBALI MBI PUNËN E KËSHILLIT DREJTUES

Neni 26

Në çdo mbledhje të Këshillit Drejtues mbahet procesverbal për punën e tij.

Procesverbali përfshin të dhënat bazë mbi punën e Kuvendit, në veçanti:

- vendin dhe datën e mbajtjes së mbledhjes
- rendin e ditës
- emrat e anëtarëve të pranishëm të Këshillit Drejtues
- emrin e kryesuesit
- emrin e procesmbajtësit
- rrjedhën e punës, sidomos çështjet për të cilat diskutohet, emrat e personave që kanë marrë pjesë në diskutim dhe përmbajtjen e përmbledhur të diskutimeve të tyre
- rezultatin e votimit sipas pikave të veçanta të rendit të ditës
- konstatimin e kryesuesit për vendimmarrjen
- mendimet kundër të anëtarëve

- kohën e përfundimit të mbledhjes.

Neni 27

Çdo vendim i Këshillit Drejtues shënohet në procesverbal.

Procesverbalit i bashkangjitet lista e pjesëmarrësve dhe dëshmitë për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Drejtues.

Neni 28

Procesverbali firmoset nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe procesmbajtësi.

Nëse procesverbali përbëhet nga më shumë faqe, Kryetari i Këshillit Drejtues dhe procesmbajtësi vendosin në çdo faqe të procesverbalit nënshkrimin e tyre të shkurtër (inicialet).

PERSONI I AUTORIZUAR PËR PËRFAQËSIM (Kryetari)

Neni 29

Personin e autorizuar për përfaqësim e emëron Këshilli Drejtues.

KOMPETENCAT E PERSONIT TË AUTORIZUAR PËR PËRFAQËSIM

Neni 30

Kompetencat e Personit të autorizuar për përfaqësim:

- menaxhon punën dhe veprimtarinë e AQ-së në tërësi
- merret me projektet zhvillimore të organizatës
- mban kontakte me donatorët dhe merret me grumbullimin e mjeteve financiare për organizatën
- lidh kontrata dhe ndërmer veprime të tjera ligjore në emër dhe për llogari të Fondacionit
- është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Fondacionit
- menaxhon punët e Fondacionit në përputhje me vendimet e Këshillit Drejtues
- i paraqet Këshillit Drejtues Propozim Raportin financiar vjetor
- merret me bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet e tjera
- ka të drejtë të shfuqizojë, ndryshojë ose pezullojë çdo vendim të Drejtorit/es ekzekutiv/e
- kryen edhe punë të tjera në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e Fondacionit.

SHKARKIMI I PERSONIT TË AUTORIZUAR PËR PËRFAQËSIM

Neni 31

Personi i autorizuar për përfaqësim mund të shkarkohet nga funksioni në rastet e mëposhtme:

1. Nëse ekzistojnë humbje në veprimtarinë e Fondacionit
2. Nëse përmes punës së tij të pakujdesshme dhe joprofesionale apo tejkalimit të kompetencave i shkakton dëm Fondacionit apo si pasojë e saj mund të jetë shkaktuar dëm
3. Për shkak të paaftësisë për të organizuar dhe menaxhuar punët që i janë besuar dhe punët nga fushëveprimi i tij.

Neni 32

Vendimin mbi shkarkimin e Personit të autorizuar për përfaqësim e merr Këshilli Drejtues me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 33

Fondacioni mund të bashkohet dhe të anëtarësohet në aleanca dhe asociacione të tjera përkatëse në vend dhe jashtë vendit.

Neni 34

Këshilli Mbikëqyrës:

Këshilli mbikëqyrës është organ i AQ-së i cili kontrollon operacionet financiare të AQ-së dhe kryen kontrollin e shpenzimeve me qëllim të caktuar dhe në mënyrë racionale të mjeteve financiare të Fondit.

Për parregullsitë e vërejtura, Këshilli Mbikëqyrës i njofton pa vonesë themeluesit.

Neni 35

Këshilli Mbikëqyrës ka të paktën tre anëtarë, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga themeluesit.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 2 vjet. I njëjti person mund të emërohet përsëri në të njëjtin funksion.

Personi i njëjtë nuk mund të jetë njëkohësisht anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe Këshillit Mbikëqyrës të AQ-së.

Neni 36

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës i thërret dhe i kryeson Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës, të cilin e zgjedhin anëtarët e Këshillit nga radhët e veta, në mbledhjen e parë të Këshillit.

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen të paktën një herë në gjashtë muaj, kurse sipas nevojës, mund të mbahen edhe më shpesh.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës e thërret mbledhjen me iniciativën e vet, me propozim të anëtarit të Këshillit Drejtues, Kryetarit dhe Drejtorit ekzekutiv të AQ-së.

Neni 37

Këshilli mbikëqyrës mund të vendosë nëse në mbledhje marrin pjesë shumica e anëtarëve të tij.

Këshilli Mbikëqyrës i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 38

Këshilli Mbikëqyrës iu raporton themeluesve mbi përdorimin me qëllim të caktuar të mjeteve financiare të AQ-së, duke dhënë propozime për ndërmarrjen e masave përkatëse.

Neni 39

Organet e AQ-së janë të obliguar që t'i ofrojnë Këshillit Mbikëqyrës të gjithë informacionin e nevojshëm mbi shpenzimin e mjeteve financiare të AQ-së dhe të dhënat e tjera relevante për ushtrimin e kontrollit, t'i sigurojnë qasje në dokumentacionin e AQ-së dhe t'i mundësojnë punë normale.

Këshilli Mbikëqyrës do të kërkojë thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të themeluesve në qoftë se gjatë ushtrimit të kontrollit zbulojnë se mjetet financiare nuk janë përdorur për qëllimin e përcaktuar ose zbulojnë parregullsi të tjera në përdorimin e mjeteve financiare të AQ-së.

Neni 40

Drejtori/ja ekzekutiv/e i/e AQ-së:

- kujdeset për zbatimin e vendimeve të organeve të AQ-së
- i ndihmon Kryetarit në menaxhimin e drejtpërdrejtë të punës së AQ-së
- merr vendimet e nevojshme për veprimtarinë e rregullt të AQ-së
- emëron dhe mbikëqyr punën e Menaxherit të Zyrës dhe kontabilistit
- mban vulën dhe vërteton dokumentet zyrtare të AQ-së
- disponon me pasurinë e AQ-së, në përputhje me Ligjin, Statutin, Planin financiar dhe vendimet e Këshillit Drejtues të AQ-së
- kryen punë të tjera që i ka besuar Kuvendi, Kryetari/ja ose Këshilli Drejtues

Zv. Drejtori/ja ekzekutiv/e zëvendëson Drejtorin/en ekzekutiv/e në rast mungese ose pengese dhe kryen punë të tjera që ia beson Drejtori/ja ekzekutiv/e ose Drejtori i programit.

Neni 41

Drejtori/ja i/e programit:

- përfaqëson dhe prezanton Zyrën
- është përgjegjës/e për hartimin e programeve dhe projekteve të reja të Zyrës
- koordinon të gjitha aktivitetet programore
- është përgjegjës/e për zbatimin e të gjitha aktiviteteve në kuadër të programeve dhe projekteve
- harton raportet përfundimtare dhe kontakton me donatorët e Zyrës qendore dhe Zyrës rajonale
- kryen të gjitha punët e tjera të nevojshme për funksionimin normal të Zyrës
- i autorizon koordinatorët për prezantimin e Zyrës në kontaktet me partnerët, donatorët dhe mediat
- i delegon kompetencat e tij te koordinatorët.

Neni 42

Drejtori/ja i/e komunikimit:

- përfaqëson dhe prezanton Zyrën
- siguron transparencën e punës së AQ-së
- është përgjegjës/e për praninë dhe imazhin publik të AQ-së
- zhvillon dhe zbaton strategjinë e komunikimit të AQ-së
- është përgjegjës/e për mbajtjen e kontakteve me media
- koordinon marrëdhëniet me publikun dhe aktivitetet e lidhura me mediat
- është përgjegjës/e për informimin e anëtarësisë mbi punën e AQ-së

Neni 43

Në përputhje me nevojat e AQ-së, Këshilli Drejtues mund të formojë trupa të tjerë të AQ-së, siç janë: këshillat, nënkëshillat, grupet e punës, komisionet, forumet etj.

Neni 44

Çështjen e përgjegjësisë së organeve dhe trupave të AQ-së mund ta inicojnë tre/i anëtarë/e të Këshillit Drejtues, Këshilli Mbikëqyrës ose Drejtori i programit.

Vendimin mbi përgjegjësinë e organeve dhe trupave e merr organi i cili i zgjedh ato.

Mënyra e punës dhe e organizimit të AQ-së

Neni 45

AQ është e organizuar sipas parimit programor dhe territorial.

AQ mund të themelojë zyrat e veta në vend dhe jashtë vendit, për ç'gjë vendos Bordi i Drejtorëve.

Për punën dhe veprimtarinë e tyre, të gjitha zyrat e AQ-së i japin llogari Drejtorit/es

ekzekutiv/e.

Mënyra e punës, komunikimit, kompetencave dhe organizimit të të gjitha zyrave, organeve dhe trupave të AQ-së rregullohet në mënyrë më të detajuar me Rregulloren e posaçme të miratuar nga Bordi i Drejtorëve, me propozim të Drejtorit/es ekzekutiv/e.

Neni 46

Për kryerjen e punëve të nevojshme për funksionimin e AQ-së, që kërkojnë njohuri të specializuara, mund të angazhohen persona të cilët nuk janë anëtarë të AQ-së.

Punësimi bëhet në përputhje me ligjin.

Për punësimin vendos Drejtori/ja i/e programit.

Financimi i AQ-së

Neni 47

AQ financohet nga:

- fondet që operojnë në përputhje me ligjin
- dhuratat
- kontributet vullnetare të qytetarëve/eve
- sponsorizimet
- të ardhurat e realizuara nga kryerja e veprimtarive fitimprurëse të personave juridikë, themelues i të cilëve është AQ-ja, siç përcaktohet në nenin 11 të këtij Statuti.
- burimet e tjera në përputhje me ligjin.

Veprimtaria financiare e AQ-së kryhet në përputhje me dispozitat pozitive, në bazë të Planit financiar të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Pushimi i punës së AQ-së

Neni 48

Fondacioni themelohet në kohë të pacaktuar.

Neni 49

Vendimin mbi pushimin e punës së AQ-së e merr Këshilli Drejtues me shumicë prej dy të tretave, në mbledhjen në të cilën marrin pjesë të paktën dy të tretat e anëtarëve/eve.

Neni 50

Në rast të pushimit të punës, tërë pasuria e Aleancës Qytetare kalon në pronësi të organizatës tjetër bamirëse jofitimprurëse apo institucionit publik për aktivitetet e tij bamirëse, për ç'gjë vendos Këshilli Drejtues i AQ-së.

Procedura e ndryshimit dhe plotësimit të Statutit

Neni 51

Iniciativën për nisjen e procedurës së ndryshimit dhe plotësimit të Statutit mund ta iniciojë themeluesi i Fondacionit si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.

Për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit vendos Këshilli Drejtues me shumicë prej dy të tretave të votave të anëtarëve të pranishëm të Fondacionit.

Neni 52

Statuti dhe ndryshimet e plotësimet e tij hyjnë në fuqi ditën e miratimit, përveç nëse me Statut nuk është parashikuar ndryshe.

Dispozitat përfundimtare

Neni 53

Në rast të pushimit të punës së Fondacionit, vendimin mbi disponimin e pasurisë e merr themeluesi i Fondacionit.

Për të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Statut do të zbatohen drejtpërdrejt dispozitat e Ligjit për Organizatat Joqeveritare.

Data e miratimit të vendimeve mbi ndryshimet dhe plotësimet e Statutit

Podgoricë, më 01. 06. 2012

Kuvendi i Aleancës Qytetare
Kryetari i Kuvendit
Boris Raoniq